



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 2849 Dt 10.11.2022

Në bazë të nenit 7, pika 1.2, nenit 14 pika 1.14, nenit 49, pika 1.9 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2022, mori:

VENDIM


1. Aprovohet draft-Rregullorja për themelimin dhe mënyrën e funksionimit të Trupit Këshillëdhënës të Njësive Akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
2. Pjesë e këtij vendimi është Rregullorja për themelimin dhe mënyrën e funksionimit të Trupit Këshillëdhënës të Njësive Akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senat.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Menaxhmentit.
3. Fakulteteve
4. Zyrës për komunikim me publikun

Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit të UIBM





**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË**

Nr. Prot. 2849 Dt. 10.11.2022

Në bazë të nenit 7, pika 1.2, nenit 14 pika 1.14, nenit 49, pika 1.9 të Statutit të Universitetit “Isa Boletini”, Mitrovicë (UIBM), Senati, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2022 miratoi këtë:

RREGULLORE

Për themelimin dhe mënyrën e funksionimit të Trupit Këshillëdhënës të Njësive Akademike të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton karakterin, anëtarësimin, funksionimin, fushëveprimin, mënyrën e vendimmarrjes dhe mandatin e Trupit Këshillëdhënës.

Neni 1

1. Karakteri i Trupit Këshillëdhënës, të themeluar në bazë të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme UIBM) dhe të kësaj rregulloreje, *është jofitimprurës dhe këshillëdhënës* dhe, bazohet në vullnetin e mirë të anëtarëve dhe në përkushtimin e njësive akademike (në tekstin e mëtejme NjA) të UIBM për ngritjen e cilësisë së Arsimit të Lartë në fushën e veprimtarisë së NjA – së.
2. Trupi Këshillëdhënës përbëhet nga përfaqësuesit e tregut të punës dhe të autoriteteve nga fushë veprimtaria e NjA – së përkatëse.
3. Përbërja dhe aktivitetet e Trupit Këshillëdhënës publikohen në ueb-faqen e UIBM – NjA.

Neni 2

1. Trupin Këshillëdhënës e themelon NjA përkatëse me propozimin e dekanit.
2. Trupi Këshillëdhënës mund të ketë deri në 11 anëtarë.
3. Dekanët e NjA-së i propozojnë anëtarët e Trupit Këshillëdhënës, emërtimin e të cilëve e miraton Këshilli i NjA-së.
4. Pas konstituimit të Trupit Këshillëdhënës dhe zgjedhjes së kryetarit, mund të propozohen edhe anëtarë të tjerë të Trupit Këshillëdhënës. Për zgjedhjen e tyre, dekani e informon Këshillin e NjA-së.

Neni 3

1. Trupi Këshillëdhënës përbehet nga përfaqësues të tregut të punës, që janë vendimmarrës në kompani private apo publike si dhe përfaqësues të autoriteteve qeveritare relevante për fushëveprimtarinë e NjA-së përkatëse.
2. Anëtarë *ex-officio* të Trupit Këshillëdhënës janë dekani dhe prodekanët e NjA-së si dhe një përfaqësues nga Universiteti ose ndonjë prej fakulteteve me fushëveprim të ngjashëm.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

3. Dekani i NjA – së përgatit mbledhjen konstitutive të Trupit Këshillëdhënës, përpilon materialet lidhur me rendin e ditës dhe ndërmerr aktivitete të tjera për mbarëvajtjen e punës së Trupit Këshillëdhënës.

Neni 4

1. Trupi Këshillëdhënës e zgjedh kryetarin nga radhët e përfaqësuesve të tregut të punës. Kryetari i Trupit Këshillëdhënës i udhëheq mbledhjet dhe kujdeset që informatat lidhur me mbledhjet të shpërndahen tek të gjithë anëtarët e vet dhe palët tjera të interesit.
2. Sipas kësaj rregulloreje dhe praktikës së mirë e transparente, Kryetari i Trupit Këshillëdhënës përkujdeset për përmbledhjen e raporteve të punës së Trupit Këshillëdhënës dhe operacionalizimin e iniciativave të tij.
3. Kryetari i Trupit Këshillëdhënës e përfaqëson Trupin Këshillëdhënës në raport me palën e tretë. Në mungesë të kryetarit, ai mund ta caktojë një zëvendës të tij.
4. Kryetari i Trupit Këshillëdhënës prezanton punën e Trupit Këshillëdhënës në organizimet e ndryshme si: Këshillin e NjA-së, Institucionet e Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, punëtori tematike etj.
5. Trupi Këshillëdhënës mund të formojë grupe punuese, të cilat përqendrohen në drejtime të veçanta të fushëveprimit të NjA-së përkatëse të tregut të punës.
6. Varësisht nga temat për diskutim, në mbledhjet e Trupit Këshillëdhënës, mund të ftohen edhe shefat e departamenteve, drejtori i Institutit të NjA – së përkatëse dhe përfaqësues të organeve përkatëse që funksionojnë në kuadër të NjA – së, por pa të drejtë vote.

Neni 5

1. Trupi Këshillëdhënës, mund t'i sugjerojë Këshillit të NjA – së përditësimin e programeve të studimeve.
2. Anëtarët e Trupit Këshillëdhënës e mbështesin realizimin e praktikës profesionale të studentëve të NjA – së, në pajtim me programet e studimit.
3. Trupi Këshillëdhënës mbështet NjA – në dhe tregun e punës të fushëveprimitarisë punuese në krijimin grupeve të përbashkëta punuese.
4. Trupi Këshillëdhënës dhe NjA bashkëpunojnë në kërkime shkencore, shërbime profesionale, ndërmjetësim për inovacione si dhe në propozime bashkëpunimi në projekte të përbashkëta me NjA – në dhe partnerët të tjerë.
5. Anëtarët e Trupit Këshillëdhënës mund të ofrojnë bursa për studentë si dhe përkrahje financiare për projekte hulumtuese të studentëve dhe stafit akademik.
6. Trupi Këshillëdhënës mund të shqyrtojë edhe çështje të tjera të propozuara nga dekani.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Neni 6

1. Trupi Këshillëdhënës mund të sugjeroj ndryshimin, përmirësimin dhe amandamentimin e rregulloreve dhe akteve të tjera në fuqi.
2. Trupi Këshillëdhënës, mund t'i propozojë Këshillit të NjA – së programe që kanë të bëjnë me mësim tërëjetësor, arsim të të rriturve dhe trajnime profesionale.
3. Trupi Këshillëdhënës bën vlerësime, rekomandime e sugjerime lidhur me kushtet e punës, laboratorët dhe lehtësira në funksionalizimin e punës.
4. Këshillat dhe sugjerimet e Trupit Këshillëdhënës për çështjet e trajtuara i adresohen Këshillit të NjA – së, Senatit të UIBM – së, menaxhmentit, Këshillit Drejtues të UIBM – së, në kuadër të hartimit të programeve të reja, aplikimit për procesin e akreditimit, caktimit të punës praktike, planifikimit të projekteve kërkimore dhe shkencore, vlerësimit të tyre, hartimit të dokumenteve strategjike, etj.

Neni 7

1. Aprovimi i propozimeve bëhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
2. Rekomandimet e Trupit Këshillëdhënës, në formë të propozimeve dorëzohen në Këshillin e NjA – së për procedim të mëtejshëm.

Neni 8

1. Mandati i anëtarëve të Trupit Këshillëdhënës zgjatë 4 (katër) vjet, me mundësi të rizgjedhjes, ndërsa numri i mandateve nuk është i kufizuar.
2. Me kërkesën e dekanit, kryetari i Trupit Këshillëdhënës, mund t'i prezantojë para Këshillit të NjA – së aktivitetet e Trupit Këshillëdhënës për periudhën e caktuar.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.


Prof. dr. Alush Musaj
Rektor

